



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 146 Prot.

Tiranë, më 25. 3 .2022
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: Njoftim për vend të lirë pune.

AGJENCISË SE PROKURIMIT PUBLIK
Shërbimi Kombëtar i Punësimit

TIRANË

Në zbatim të Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë” i ndryshuar, Urdhërin e Kryeministrit Nr.20, datë 26.01.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, dhe në VKM Nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësme drejtuese”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për **3 (tre) vende të lira pune në pozicionin e Specialistit pranë Sektorit të Promocionit dhe Vlerësimit të Cilësisë.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master ose ekuivalent me të, preferohen me formim në një nga fushat, shkencë natyrore, humane dhe shoqërore, me notë mesatare të të gjitha niveleve të studimit mbi 8.5 (tetë. pesë).
2. Preferohen kandidatë të cilët kanë përvojë pune në administratën publike.
3. Të zotërojë gjuhën angleze.
4. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:

1. Të ketë njohuri për legjislacionin bazë të arsimit të lartë në përgjithësi dhe atij që lidhet me cilësinë.
2. Preferohen candidate që kanë njohuri për legjislacionin bazë të arsimit të lartë dhe njohuri mbi institucionet, programet e studimit, procedurat, kriteret dhe aktet nënligjore të sistemit të akreditimit.
3. Të ketë njohuri praktike në menaxhimin e proceseve të vlerësimit.
4. Të ketë dhe dëshmojë aftësi të mira shkrimi dhe komunikuese.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

5. Të dëshmojë aftësi për të punuar në grup.

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*)
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces
5. Fotokopjen e librezës së punës; e noterizuar
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj e noterizuar
7. Fotokopje të dëshmimeve të kualifikimeve të kryera, të noterizuara
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm.
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj të shkruar dhe folur, dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 08.04.2022, ora 12.00 në adresën e mëposhtme;

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
Rruga e Durrësit, pranë Gjinnazit “Qemal Stafa”
Tel: 4 22 43 423**

- Njoftimi të bëhet edhe në web site e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë; www.ascal.al

DREJTORI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
PËRGJEGJËS SEKTORI PVC**

Xhiliola Bixheku



Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al